

DEKRET
Nr. 452, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Komandar i Urdhrit të Lisit Akademik”
zonjës Fioralba Cakoni**

“Në vlerësim të kontributit të saj shumë të spikatur si matematiciene e afirmuar brenda dhe jashtë vendit, me një veprimtari kërkimore shkencore, universitare dhe akademike të kurorëzuar nga vlerësime ndërkombëtare dhe përkatësi në katedra autoritative shkencore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjetkë, pa lënë mënjane angazhimin e lavdërueshëm në organizimin e shkollës verore për metodat matematike dhe analizën e të dhënave në Shqipëri, duke dëshmuar me profesionalizëm dhe vizion rëndësinë jetike të diasporës në përcjelljen e dijeve dhe përvojave më të mira në vendin amë”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj